



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
____.2022

Tiranë, më

VENDIM

Nr. 59, datë 15.02.2022

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nëntregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Roli i gjyqtarit në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njej ligjin*”. Në këtë kontekst, gjyqtarit i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, të cilët do të përcaktojnë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë, edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e çështjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi nga ana e gjyqtarit {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën

ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor (shih dosjet 3, 4 dhe 5), si dhe kualifikimin ligjor të veprës penale. Identifikon rastet kur për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertë të fushës (shih dosjen 3). Zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe sipas rastit për dënimin e të pandehurit ka vlerësuar se duhet aplikuar neni 59 apo 63 i K.Penal (shih dosjet 1 e 2). Zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi dhe për pasojë, në disa raste, palët bien dakord me zgjidhjen e çështjes dhe nuk e kundërshtojnë vendimin e dhënë në gjykatat më të larta (shih dosjet 1, 3-5). Kur është rasti, për zgjidhjen e çështjes përdor ligjin posaçëm (shih dosjen 5)...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi në rastin konkret ndahen në dy grupe kryesore për shkak të lëndës (civile dhe penale), kategorizim i cili ndikon edhe në mënyrën e përcaktimit dhe analizimit të fakteve të çështjes, në përcaktimin e natyrës së saj dhe identifikimin e ligjit të zbatueshëm.

Në çështjet civile, gjyqtari përcakton dhe përshkruan në mënyrë të përmbledhur faktet e çështjes në pjesën e dytë të arsyetimit të vendimit, pas parashtrimit të rrethanave procedurale. Paraqitja e fakteve të çështjes, është e qartë dhe bëhet duke integruar edhe provat mbi të cilat kanë rezultuar faktet konkrete dhe pretendimet e palëve lidhur me faktin objekt shqyrtimi dhe kërkimet e tyre në raport me objektin e mosmarrëveshjes. Përveç përshkrimit të fakteve të çështjes në pjesën e dytë të arsyetimit të çdo vendimi, së bashku me referimin tek provat mbi të cilat ato mbështeten, rrethanat e faktit rimerren në shqyrtim në pjesën e arsyetimit ligjor, me qëllim për të mbështetur argumentet e gjyqtarit, në shërbim të konkluzioneve sa i përket objektit të padisë/çështjes, apo pretendimeve të palëve ndërgjyqëse.

Në çështjet penale, në shtatë vendimet e analizuara, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli ose kërkesë penale*), apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtari i ka kushtuar rëndësi përcaktimit të fakteve të çështjes dhe përshkrimit të tyre në disa pjesë të arsyetimit të vendimit, duke integruar në përshkrimin e tij provat mbi të cilat ka rezultuar i mbështetur fakti konkret. Në këto vendime, rrethanat e faktit vijnë menjëherë pas prezantimit të çështjes dhe arsyetimit lidhur me kërkesat procedurale të palëve, sikurse është rasti i pranimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar. Në çështjet penale të themelit, pavarësisht ritit të gjykimit (*gjykim i shkurtuar ose i zakonshëm*), gjyqtari paraqet në mënyrë të hollësishme dhe koncize faktet e provuara në gjykim, duke i përshkruar ato nëpërmjet referimit dhe analizës së provave në mënyrë të integruar me njëra tjetrën. Në çështjen në të cilën objekt i gjykimit ka qenë kërkesa për vleftësim ndalimi dhe caktim mase sigurimi, rrethanat e faktit, së bashku me rrethanat procedurale të ndalimit, apo caktimit të masës, përcaktohen në pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, duke referuar provat e administruara në proces dhe faktet konkrete

të çështjes apo elementët proceduralë për të cilët referojnë provat e administruara, duke ndjekur kryesisht rendin kronologjik të prezantimit të tyre.¹

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara (civile dhe penale), natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i gjykimit dhe analiza e faktit penal ose civil, pavarësisht se nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur nga gjyqtari në arsyetimin e vendimit.

Në çështjet penale, identifikimi i natyrës së çështjes, rezulton i qartë nga objekti i gjykimit dhe përshkrimi i qartë i fakteve të çështjes, duke orientuar më pas dhe arsyetimin ligjor, sipas rastit, në drejtim të provueshmërisë së elementëve të figurës së veprës penale për çështjet e themelit, ose në drejtim të ekzistencës së kushteve dhe kritereve të vleftësimit të ligjshëm të ndalimit, si dhe caktimin e masës së sigurimit personal.

Në çështjet civile të analizuara, natyra e çështjes nuk përcaktohet në mënyrë deklarative nga gjyqtari, por rezulton e qartë dhe e kuptueshme nga objekti i çështjes, nga rrethanat e faktit dhe paraqitja nga ana e gjyqtarit e thelbit të kërimit të palës paditëse, duke qartësuar natyrën e kërimit, si: padi për kërkim shume, për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të dokumentit, apo si një mosmarrëveshje që rrjedh nga marrëdhëniet e dhunës në familje, etj.

Në tërësinë e vendimeve të analizuara, identifikimi dhe përshkrimi i qartë, i saktë, i faktit juridik objekt shqyrtimi, pavarësisht nëse natyra e çështjes është përcaktuar ose jo shprehimisht nga gjyqtari në arsyetim, sjell si pasojë identifikimin në mënyrë të qartë të marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur konflikti në rastin e çështjeve civile, ose të natyrës së çështjes penale objekt gjykimi, duke orientuar qartë lexuesin për thelbin e çështjes, si dhe duke shërbyer si element orientues për arsyetimin ligjor të vendimit, në bazë të llojit të çështjes (penale themeli, kërkesë penale, çështje civile themeli, familjare themeli).

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtari identifikon ligjin e zbatueshëm, citon në disa raste dispozita të ligjit material ose procedural, si dhe analizon kur është vlerësuar e nevojshme përmbajtjen e tyre, në mënyrë të integruar me faktin, ose në mënyrë të pavarur, para aplikimit mbi faktet e çështjes. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në dy kategori: (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm procedural dhe material, rezulton si më poshtë:

¹ Vendimi nr. 476, datë 22.12.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

(i) Në vendimet civile (çështje me pavërtetësi dokumenti, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, kthim shume, deklarim i pavlefshmërisë absolute të aktit, ndryshim vendimi dhe vërtetim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes), gjyqtari identifikon dhe referon drejtpërdrejt në pjesën hyrëse dhe në përmbajtje të arsytimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenin 193 të K.Pr.Civile, lidhur me thirrjen e personit të tretë;²
- nenin 70 të K.Pr.Penale, lidhur me efektin e vendimeve penale në procesin civil; nenet 214, 281 dhe 284 të K.Pr.Civile, lidhur me pohimin gjyqësor dhe vlerën provuese të tyre, pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes; 3
- nenin 106 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e detyrimit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore;⁴
- nenet 510 dhe 511/a të K.Pr.Civile, në lidhje me fazën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë.⁵

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në të gjitha çështjet civile, referuar objektit të mosmarrëveshjes, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm:

- nenet 463 dhe 464 të K.Civil, lidhur me afatin e ekzekutimit të detyrimit;⁶
- nenin 92/a të K.Civil lidhur me pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, nenet 64 dhe 70 të K.Civil, lidhur me kuptimin e përfaqësimit dhe të përfaqësimit me prokurë;⁷
- nenin 159 të K.Familjes, lidhur me ndryshimin e vendimit gjyqësor për sa i përket ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, për shkak të ndryshimit të rrethanave;⁸
- në lidhje me kushtet dhe kriteret për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe verifikimin e tij, identifikon si ligj të zbatueshëm, si në aspektin procedural ashtu edhe atë material, dispozita të ligjit të posaçëm nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar
- dispozitat materiale të ligjit të posaçëm, nenin 3 paragrafi 1, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, në lidhje me përkufizimin e “dhunës në familje”, nenin 3 pika 3, lidhur me kategorinë e subjekteve që merren në mbrojtje në kuadër të këtij ligji, nenin 3 për të përcaktuar se cilat veprime dhe mosveprime do të kualifikohen si “dhunë” në kuptim të këtij ligji, për të gëzuar mbrojtje pala e dhunuar, si dhe qëllimin e ligjit të posaçëm, në lidhje me zgjidhjen e çështjes;⁹
- nenin 43/4 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, lidhur me vlefshmërinë dhe kundërshtimin e aktit të lindjes;¹⁰

(ii) Në vendimet penale, gjyqtari identifikon, citon dhe në disa raste analizon ligjin e zbatueshëm, procedural dhe material, si pjesë të integruar të arsytimit të vendimit, për të vlerësuar rrethanat procedurale të çështjes, apo për të analizuar elementët e figurës së

² Vendimi nr. 83, datë 15.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

³ Vendimi nr. 449, datë 15.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁴ Vendimi nr. 2, datë 05.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵ Vendimi nr. 487, datë 20.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁶ Vendimi nr. 449, datë 15.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁷ Vendimi nr. 83, datë 15.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁸ Vendimi nr. 190, datë 10.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁹ Vendimi nr. 4, datë 27.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁰ Vendimi nr. 23, datë 19.01.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

veprës penale, përcaktimin dhe individualizimin e dënimit dhe aplikimin e dënimeve alternative, disponimin për provat materiale, etj.

Sa i përket ligjit procedural penal, gjyqtari ka identifikuar si ligj të zbatueshëm:

- nenin 404 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar dhe nenin 406 të K.Pr.Penale lidhur me uljen e masës së dënimit;
- nenet 76 dhe 77 të K.Pr.Penale sa i përket përcaktimit të kompetencës tokësore të hetimit të veprës penale të regjistruar, nenet 253, 255, 258 dhe 228 të K.Pr.Penale, për efekt të vlerësimit të kushteve ligjore të ligjshmërisë së ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit;¹¹
- nenin 369 të K.Pr.Penale në lidhje me leximet e lejueshme të deklarimeve të dëshmitarëve, të dhëna përpara oficerit të policisë gjyqësore;¹²
- nenet 190 dhe 393 të K.Pr.Penale sa i përket disponimit për provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në vendimet penale të analizuara konstatohet se gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.

- Konkretisht, gjyqtari identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penal nenin 79/dh të K.Penal në lidhje me veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, nenin 76 të K.Penal, në lidhje me veprën penale “Vrasja me dashje”, nenin 278 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”;¹³ nenin 197 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”;¹⁴ nenin 134 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Vjedhja”;¹⁵ nenin 291 të K.Penal në lidhje me akuzën për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe nenin 242 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Mosbindja ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik”¹⁶ dhe nenin 189 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”.¹⁷

Në këto vendime, veç dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit dhe individualizimin e tij. Konkretisht, gjyqtari ka identifikuar nenin 47 të K.Penal, sa i përket kushteve të caktimit të llojit dhe masës së dënimit dhe nenet 48 dhe 50 të K.Penal, lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

¹¹ Vendimi nr. 476, datë 22.12.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹² Vendimi nr. 3, datë 07.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹³ Vendimi nr. 404, datë 30.09.2014 dhe nr. 3, datë 07.01.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁴ Vendimi nr. 510, datë 25.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁵ Vendimi nr. 220, datë 12.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë..

¹⁶ Vendimi nr. 22, datë 27.01.2014 dhe nr. 383, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁷ Vendimi nr. 37, datë 02.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezultojnë të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Ai ka aftësitë e duhura në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor (shih dosjet 3, 4 dhe 5), si dhe kualifikimin ligjor të veprës penale. Identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertë të fushës (shih dosjen 3). Zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe sipas rastiit për dënimin e të pandehurit ka vlerësuar se duhet aplikuar neni 59 apo 63 i K.Penal (shih dosjet 1 e 2). Zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi dhe për pasojë, në disa raste, palët bien dakord me zgjidhjen e çështjes dhe nuk e kundërshtojnë vendimin e dhënë në gjykatat më të larta (shih dosjet 1, 3-5). Kur është rasti, për zgjidhjen e çështjes përdor ligjin posaçëm (shih dosjen 5). Ai njeh parimet e përgjithshme

të së drejtës dhe i zbaton ato gjatë gjykimit, por nuk i përdor shprehimisht në tekstin e vendimeve përfundimtare. Gjyqtari {...} ka njohuri në të drejtën penale, ku kombinon mirë rregullat e pjesës së përgjithshme me ato të pjesës së posaçme të Kodit Penal (shih dokumentet 1, 2 dhe dosjet 1, 2). Gjithashtu, ai ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale, lidhur me vleftësimin e caktimin e masave të sigurimit (shih dokumentin 3) dhe në të drejtën civile lidhur me (shih dosjet 3, 4 e 5). Në një rast konstatohen njohuri të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" në çështjen për lëshimin dhe vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes (shih dosjen 5)".

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike *procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen ose referohen, duke u shoqëruar në disa raste me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, në funksion të analizës juridike dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile ose të çështjes penale, objekt shqyrtimi.

- **Në drejtim të interpretimit të ligjit procedural:**

Nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi rezulton se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi interpretimit të disa dispozitave procedurale që zbatohen mbi rrethanat procedurale, duke u ndalur vetëm në disa raste në interpretimin teorik të tyre dhe në shumicën e rasteve në aplikimin e drejtpërdrejtë të tyre mbi faktet e çështjes.

Në vendimet penale të analizuara rezulton:

- interpretimi i nenit 77 të K.Pr.Penale, në lidhje me kompetencën tokësore për veprat penale të kryera jashtë shtetit, duke konkluduar se gjykata është kompetente për gjykimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit;¹⁸
- interpretimi i nenit 404 të K.Pr.Penale, në lidhje me kushtet procedurale të pranueshmërisë së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.

Në vendimet civile të analizuara, sa i përket ligjit procedural, normat referohen dhe citohen duke u aplikuar mbi aspektet procedurale në funksion të të cilave ato referohen (*thirrjen e personit të tretë, vlerën provuese të pohimit gjyqësor dhe efektin e vendimeve penale në procesin civil*), pa u shoqëruar me interpretim të pavarur të kuptimit të tyre, përveç interpretimit të neneve 32/c dhe 270 të K.Pr.Civile në lidhje me përcaktimin e interesit të ligjshëm të paditësit për të kërkuar konstatimin e pavërtetësisë së kontratës së dhurimit, për shkak se është një akt i falsifikuar.¹⁹ Interpretimi i kufizuar i normave procedurale në vendimet civile të analizuara në rastin konkret duket se është kushtëzuar edhe nga objekti i mosmarrëveshjeve të trajtuara, të cilat nuk rezulton të kenë elementë apo aspekte procedurale të cilat janë vënë në diskutim, çka do të bënte të nevojshëm interpretimin e pavarur të dispozitave të caktuara procedurale.

¹⁸ Vendimi nr. 37, datë 02.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁹ Vendimi nr. 669, datë 04.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

- Në drejtim të interpretimit të ligjit material:

Sa i përket interpretimit të ligjit material të zbatueshëm, sipas natyrës së vendimit, rezulton se gjyqtari ka interpretuar dispozitat respektive në mënyrë të pavarur vetëm në disa raste, kryesisht në vendimet penale, ndërsa në rastet e tjera, pas citimit të dispozitave, vijon me aplikimin e tyre mbi faktet e çështjes në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa i shoqëruar ato me interpretim të kuptimit dhe qëllimit të tyre.

Në vendimet civile burim vlerësimi, interpretimi i normës juridike bëhet vetëm në disa raste, duke identifikuar qëllimin e normës, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen, në mënyrë që të gjejë zbatim dispozita, në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore evidentohet se gjyqtari interpreton dispozita të ligjit material, si vijon:

- Gjyqtari interpreton në mënyrë abstrakte nenin 159 të Kodit të Familjes, para aplikimit të tij mbi faktet e çështjes, në shërbim të konkluzionit të arritur lidhur me zbatimin e tij në zgjidhjen e çështjes;²⁰
- Gjyqtari interpreton dispozitat materiale të ligjit të posaçëm nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në lidhje me kategorinë e subjekteve që merren në mbrojtje, në kuadër të këtij ligji. Gjyqtari interpreton nenin 3 për të përcaktuar se cilat veprime dhe mosveprime do të kualifikohen si dhunë në kuptim të këtij ligji, për të gëzuar mbrojtje pala e dhunuar, si dhe qëllimin e ligjit të posaçëm në lidhje me zgjidhjen e çështjes.²¹

Në vendimet e tjera civile të analizuara, dispozitat janë cituar dhe zbatuar drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, pa u shoqëruar me një interpretim të pavarur të tyre.

Në vendimet penale të analizuara, kryesisht në vendimet e themelit, gjyqtari citon nenet e pjesës së posaçme të Kodit Penal dhe i interpreton ato në drejtim të vlerësimit lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, si dhe analizës së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën procedohet i pandehuri. Në këto vendime interpretohen gjithashtu dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në drejtim të përcaktimit të kushteve dhe kriterëve të individualizimit të dënimit, sipas parashikimeve të nenit 47 të Kodit Penal, kushte të cilat referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet e çështjes, duke u shoqëruar me një analizë të shkurtër të tyre, pa qëndruar në interpretimin e veçantë dhe abstrakt të tyre.

Në vendimin me objekt kërkesë në fazën e hetimit paraprak, nuk rezulton të ketë interpretim të dispozitave të ligjit penal material, kushtëzuar nga objekti i kërkesës, e cila nuk ka në fokus vlerësimin e ekzistencës dhe provueshmërisë së faktit penal apo elementëve të tjerë, në të cilat gjejnë zbatim dispozita të ligjit material, pasi është kërkesë me natyrë ngushtësisht procedurale.²²

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:

²⁰ Vendimi nr. 190, datë 10.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

²¹ Vendimi nr. 4, datë 27.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

²² Vendimi nr. 476, datë 22.12.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Nga tërësia e vendimeve të analizuara rezulton se gjyqtari në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtari njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

Parimi i procesit të rregullt ligjor, aspekte të cilat rezultojnë nga konteksti i vendimeve të analizuara, në të cilat rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi elementëve të tillë si: disponibiliteti i padisë nga ana e paditësit, barra e provës, kontradiktoriteti, etj.

Parimi i prezumimit të pafajësisë i sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përcaktimin e përgjegjësisë penale të autorit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”;

- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.***

Në vendimet e analizuara në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën, evidentohet se gjyqtari nuk ka identifikuar apo përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij.

Në tërësi, në vendimet përfundimtare të analizuara, gjyqtari i ka kushtuar rëndësi interpretimit të dispozitave procedurale dhe materiale vetëm në disa prej vendimeve, kryesisht në vendimet penale të themelit, si dhe në disa vendime civile, duke u ndalur kryesisht në interpretimin më të zgjeruar të normave materiale, kryesisht të ligjit penal. Në çështjet civile, interpretimi i ligjit, si në aspektin procedural edhe atë material, pavarësisht natyrës së mosmarrëveshjes, nuk rezulton të jetë në të njëjtën masë si në vendimet penale të themelit, pasi në këto vendime dispozitat referohen, citohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi rrethanat procedurale përkatëse apo mbi faktet e çështjes, pa u ndalur në interpretimin e pavarur dhe dhënien e arsyeve të aplikimit të tyre, përveç dy vendimeve civile, në të cilat interpretohet neni 159 i Kodit të Familjes dhe dispozitat materiale të ligjit të posaçëm nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Por interpretimi i ligjit nuk zë të njëjtën peshë të në të gjitha vendimet, pasi në një pjesë të tyre, kryesisht në vendimet civile të analizuara, gjyqtari referon, citon dhe aplikon drejtpërdrejt ligjin mbi faktet e çështjes, pa u ndalur në dhënien e kuptimit të tij dhe arsyet e zbatimit të tij mbi faktet konkrete. Gjithashtu, nuk evidentohet në asnjë rast identifikimi apo zbatimi i praktikës gjyqësore unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qartë dhe të kuptueshëm. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por në rastet e vëzhguara nuk përdoret karakteri i gjuhës shqipe “ë”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese.

Gjyqtari, përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe koncize. Nuk konstatohet përdorimi në mënyrë të përhershme i shkronjave “ç” dhe “ë” në hartimin e vendimit. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma teknikë, apo fjalë që krijojnë konfuzion lidhur me kuptimin dhe kontekstin e përdorimit të tyre. Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, gjyqtari i referon ato në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të thjeshta, të ndërthurura me njëra tjetrën dhe të kuptueshme. Vendimet janë të organizuar përgjithësisht në paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe duke përdorur fjali hyrëse për paragrafë të caktuar, me qëllim orientimin e lexuesit për përmbajtjen e tyre.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme e përdorur në arsyetim dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë një lexim të organizuar, që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Paragrafët, në shumicën e vendimeve të analizuara, fillojnë me një fjali identifikuese (titull), e cila orienton përmbajtjen e tij. Mënyra e të shkruarit dhe organizimit të mendimit dhe shprehjes së tij i jep vendimeve qartësi dhe kuptueshmëri, duke e bërë arsyetimin e vendimeve të rrjedhë në mënyrë logjike.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil (shih dosjet 3, 4 dhe 5) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shih dokumentet 1-3 e dosjet 1 e 2). Subjekti i rivlerësimit duket që përdor të njëjtën strukturë në hartimin e vendimit....Dispozitivi i vendimit është i plotë dhe i qartë sipas përcaktimeve të dispozitave procedurale civile apo penale. Kur është rasti shoqërohet edhe me urdhrin e ekzekutimit, por në dispozitivin e tij nuk është treguar zyra e përmbarimit shtetëror ose privat, si subjekti që ngarkohet për ekzekutimin e detyrueshëm të këtij vendimi, si dhe fakti që urdhri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje”.

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të qartë, duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit.

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti i shqyrtimit, akuza ndaj të pandehurit/objekti i padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa nën-pjesë dhe organizimi i saj në aspektin strukturor, ndryshon në vendimet civile, nga ato penale.

Në vendimet civile, gjyqtari ka ndjekur një strukturë organizimi të vendimit, pothuajse të njëjtë. Konkretisht, arsyetimi fillon me nën-ndarjen të titulluar “Procedura e gjykimit”, ku gjyqtari prezanton çështjen, përshkruan në mënyrë të shkurtër aspektet procedurale lidhur faktin që çështja është rikthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit, apo evidenton kërkesat procedurale të palëve, siç është rasti i kërkesës për thirrjen në cilësinë e personit të tretë. Më pas në nën-ndarjen të titulluar “Faktet e çështjes”, gjyqtari përshkruan dhe analizon faktet e çështjes, duke integruar në përmbajtje edhe analizën e provave mbi të cilat faktet kanë rezultuar të provuara. Arsyetimi vijon me paraqitjen në mënyrë të përmbledhur të pretendimeve të palëve. Më tej, arsyetimi vijon me nën-ndarjen të titulluar “Vlerësimi i gjykatës” apo “Në bazë të së drejtës”, ku gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me paraqitjen e konkluzionit të gjykatës, lidhur me pranimin apo rrëzimin e padisë.

Në vendimet penale, të analizuara, pjesa përshkruese-arsyetuese përgjithësisht është e ndarë në disa pjesë të listuara formalisht si “Procedura e gjykimit”, “Faktet e çështjes”, “Në bazë të së drejtës”. Në të analizohen: (i) Procedura - në të cilën gjyqtari shkurtimisht ndalet në disa rrethana procedurale në lidhje me kërkesën për të proceduar me gjykim të shkurtuar, së bashku me argumentet për vendimmarrjen respektive të gjykatës lidhur me to; (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes - në të cilën gjyqtari e përshkruan faktin në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese, faktet e çështjes përshkruhen në përputhje dhe të integruara me provat e administruara gjatë gjykimit. (iii) Vlerësimi i gjykatës - në të cilën gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit, si në vendimet civile, ashtu edhe në ato familjare, gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me pranimin/rrëzimin e padisë, përcaktimin e detyrimeve të palës së paditur, në rastet kur padia është pranuar tërësisht ose pjesërisht, përcaktimi i cilësisë së vendimit si titull ekzekutiv, disponimi për shpenzimet gjyqësore dhe të drejtën e ankimit. Në vendimet civile që përmbajnë detyrime gjyqtari ka nxjerrë vendim për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, në referim të parashikimeve të nenit 511/1 të K.Pr.Civile.²³ Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile, si dhe në nenin 17 pika 3 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” në rastin e vendimit gjyqësor të lëshimit të urdhrin të mbrojtjes. Në vendimet penale, pjesa e dispozitivit përmban disponimin lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, dënimin e të pandehurit/caktimin e masës së sigurimit, masën e dënimit, aplikimin e gjyqimit të shkurtuar, mënyrën e vuajtjes së dënimit, aplikimin e dënimit alternativ dhe detyrimet përkatëse, shpenzimet procedurale, të drejtën e ankimit, si dhe vendin dhe datën e shpalljes së vendimit.

Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, ku gjyqtari zbaton rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ndjek një strukturë përgjithësisht të njëjtë në arsyetimin e vendimeve, të ndarë në pjesë të cilat identifikohen nga titujt, ose nga një fjali tematike kryesore. Në shumicën e vendimeve të analizuara, gjyqtari strukturon qartë mendimin dhe argumentimin logjik, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit. Nga ana tjetër, ndarja në pjesë sipas përmbajtjes dhe ndarja e tyre në paragrafë të cilët kanë gjatësi mesatare dhe përmbajnë analizën e një elementi të caktuar të arsyetimit, e bën strukturën e vendimit funksionale dhe i jep lehtësi në lexim dhe kuptueshmëri, e favorizuar kjo edhe nga natyra jo tepër komplekse e çështjeve të analizuara.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

²³ Në nenin 511/1 të K.Pr.Civile, para ndryshimeve me ligjet nr. nr. 114/2016, datë 3.11.2016; nr. 38/2017, 30.3.2017, parashikohet se : “Për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, urdhri i ekzekutimit lëshohet së bashku me vendimin gjyqësor dhe bëhet i ekzekutueshëm nga përbaruesi gjyqësor vetëm pas konfirmimit nga kancelari. Kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit vetëm pasi verifikon se vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë”.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, si dhe ligjit specifik të zbatueshëm dhe në to nuk ka gabime logjike apo ligjore. Në përgjithësi tipar i punës së tij është fokusimi i arsytimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi i tij sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsytim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina....Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor”*.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel i mirë arsytimi, i qartë, i plotë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të procedimit. Arsytimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal, duke u kujdesur në disa raste për identifikimin dhe analizimin e koncepteve ligjore specifike, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Gjyqtari përshkruan dhe analizon në mënyrë të qartë faktet e çështjes, duke integruar në këtë analizë pjesë të provave, ose faktet që rezultojnë prej tyre, çka e bën të qartë dhe të kuptueshme analizën e faktit dhe orienton me tej argumentimin logjik lidhur me pretendimet e palëve, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Përgjithësisht, në vendimet burim vlerësimi, arsytimi dhe argumentimi ligjor bëhet duke iu përgjigjur konkluzionit që gjyqtari arrin lidhur me objektin e padisë/cilësimit juridik të faktit penal, konkluzion që paraqitet menjëherë pas faktit dhe paraqitjes së pretendimeve të palëve.

Kryesisht, në vendimet penale të themelit, gjyqtari i kushton një vëmendje më të posaçme arsytimit të vendimeve, dhënies së argumenteve ligjore të plota lidhur me faktin penal

objekt akuze, provueshmërinë e tij, cilësimin ligjor të faktit, si dhe autorësinë e të pandehurit. Në vendimet civile, cilësia e arsytimit dhe niveli i argumentimit logjik janë më të dukshme në disa prej vendimeve, kryesisht në vendimet në lidhje me çështjet familjare, ndërsa në vendimet e tjera arsytimi përqendrohet kryesisht në paraqitjen dhe analizën e rrethanave të provuara në gjykim, në raport me kërkimin objekt padie, pa u ndalur në mënyrë të posaçme në dhënien e argumenteve të zgjeruara ligjore mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktet konkrete. Në këto vendime, ligji material dhe dispozitat procedurale referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, duke u lidhur menjëherë me konkluzionin e arritur, pa u ndalur në interpretimin e ligjit dhe integrimin e tij me argumentet e gjyqtarit mbi faktet e çështjes. Megjithatë, duhet theksuar se cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik në një pjesë të vendimeve të analizuara, kryesisht në disa prej vendimeve civile, është i kushtëzuar dhe nga natyra e mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila në këto raste ka natyrë të thjeshtë, ose karakter tërësisht procedural, duke kufizuar nevojën e kryerjes së një analize të zgjeruar ligjore.

Pavarësisht natyrës komplekse ose jo të çështjes, gjyqtari ka evidentuar në çdo rast në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar më pas arsytimin e vendimit, interpretimin e ligjit dhe përqsajen e tij të drejtpërdrejtë me faktin e provuar në gjykim, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Evidentohet se në vendimet penale ku është disponuar për aplikimin e alternativave të dënimit, nuk rezulton që gjyqtari të jetë ndalur në argumentimin se cilat janë kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri një dënim alternativ, siç është ai i parashikuar në nenin 63 të Kodit Penal²⁴ si dhe kushteve të aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal.²⁵

Pavarësisht peshës së arsytimit ligjor, e cila nuk është e njëjtë në të gjitha vendimet e analizuara, në çdo rast, mënyra e organizimit dhe paraqitjes së analizës së faktit dhe ligjit, dhe argumentimi, përmban lidhjen logjike shkak-pasojë, mes çështjeve të shtruar për zgjidhje, referuar objektit të padisë civile ose objektit të çështjes penale, me konkluzionet e arritura nga gjyqtari. Kjo lidhje në disa vendime vjen si pasojë e aplikimit të drejtpërdrejtë të ligjit të zbatueshëm mbi faktet e provuara në gjykim, ndërsa në disa prej vendimeve vjen si pasojë e një analize më të plotë mbi interpretimin dhe dhënien e arsyeve të mënyrës së zbatimit të ligjit mbi faktet, në shërbim të konkluzioneve të arritura.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, aftësi të cilat reflektohen në mënyrë më të plotë në disa prej vendimeve të analizuara, kryesisht në vendimet penale të themelit dhe në disa prej vendimeve civile të

²⁴ Vendimi nr. 22, datë 27.01.2014 dhe nr. 383, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

²⁵ Vendimi nr. 37, datë 02.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

analizuara, ndërkohë që në pjesën tjetër të tyre analiza është e qartë, por nuk reflekton të njëjtën shkallë kujdesi për pasurimin e saj me elementë cilësorë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Mbi mesatar”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	90

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Ndër këto 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste është respektuar afati standard e ai ligjor i gjykimit (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 5)... Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore, të cilat janë 2 vendime penale dhe një masë sigurimi, të paraqitura

nga vetë subjekti i rivlerësimit konstatohet se ato kanë zgjatur 5 muaj e 12 ditë (shih dokumentin 1), 11 muaj e 4 ditë (shih dokumentin 2) dhe 2 ditë (shih dokumentin 3). Në të treja këto raste, gjykimi ka përfunduar brenda afatit standard të Sistemit të Vlerësimit pika 5 gërma "a", i cili është 12 muaj dhe brenda afatit ligjor (48 orë) të parashikuar në K.Pr.Penale”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari, si dhe vendimeve të administruar për shkak të ankesave.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 4 (katër) vendimeve të administruar për shkak të ankesave dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 3 (tre) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes. Konkretisht:

- (i) Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (*vleftësim ndalimi dhe caktim mase sigurimi*), parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 24 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale. Referuar vendimit nr. 476, datë 22.12.2016, rezulton se kërkesa për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit është regjistruar në gjykatë, në datën 20.12.2016 dhe ka përfunduar në datën 22.12.2016, duke përfunduar brenda afatit ligjor prej 48 orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.
- (ii) Çështja me objekt “Lëshimi i urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes”, si dhe “Verifikimi i urdhrimit të mbrojtjes”, regjistruar në gjykatë në datën 07.01.2015, përfunduar me vendimin nr. 4, datë 27.01.2015, ka përfunduar për 20 ditë, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 19 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, dhe kërkesa për lëshimin e urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes është shqyrtuar brenda afatit ligjor 48 orë, të parashikuar në nenin 18 të po këtij ligji.
- (iii) Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (*zëvendësim i masës së sigurimit*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 5 ditor nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 260 të K.Pr.Penale. Referuar vendimit nr.64, datë 18.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, rezulton se kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit është regjistruar në datën 11.02.2016, duke përfunduar për 7 ditë, jashtë afatit ligjor prej 5 ditësh, të parashikuar në nenin 260 të K.Pr.Penale.²⁶

²⁶ Sipas të dhënave të referuara në vendimin nr. 373, datë 23.04.2021 të KPK, në faqen 24 të tij.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër, në të cilat vetëm për 3 (tre) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe vetëm në 1 (një) çështje rezulton që gjyqtari të ketë shkelur afatin ligjor për përfundimin e saj, e shprehur në përqindje 33.3% e çështjeve janë gjykuar jashtë afatit ligjor.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 33.3% përkon me nivelin e vlerësimit 6 (gjashtë) pikë. Megjithatë, përveç analizës matematike, vlerësuesi duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në referim të shpjegimeve të dhëna nga gjyqtari,²⁷ rezulton se tejkalimi i afatit ligjor në çështjen e gjykuar jashtë afatit ka ardhur për shkaqe procedurale. Konkretisht, janë zhvilluar tre seanca gjyqësore, dy nga të cilat rezultojnë të kenë qenë joproductive dhe janë shtyrë për shkak të mungesës së kërkesit, apo për shkak të mosparaqitjes të përfaqësuesit të zgjedhur, rrethana këto që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Gjithsesi, gjyqtari seancat i ka planifikuar në një kohë shumë të afërt, pasi çështja ka përfunduar për 7 ditë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre, me përjashtim të një çështjeje, e cila ka zgjatur tej afatit ligjor, por për shkaqe procedurale. Referuar edhe metodologjisë së pikëzimit, ku përcaktohet se të dhënat analizohen sipas situatës, me qëllim shmangien e përfundimeve që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, gjyqtari {...} lidhur me treguesin “Respektim i afateve ligjore” vlerësohet në nivelin “0-10%”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, në kushtet kur nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor, gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

²⁷ Të pasqyruar në faqen 24-25 të vendimit nr. 373, datë 23.04.2021 të KPK

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5) deri në 10 muaj e 6 ditë (shih dosjen 4). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 10 muaj e 6 ditë ka qenë çështje civile themeli, në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim themeli pranimit i padisë dhe vendimi ka marrë formë të prerë në 04.05.2016 pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse (shih dosjen 4). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë i muaj e 2 ditë (shih dosjen 1), 1 muaj e 25 ditë (shih dosjen 2) dhe 3 muaj e 19 ditë (shih dosjen 3). Ndër këto 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste është respektuar afati standard e ai ligjor i gjykimit (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 5). Ndërsa në 1 rast afati standard i gjykimit prej 6 muajsh për çështjen civile është tejkaluar (shih dosjen 4). Shkak për tejkalimin e afatit standard kanë qenë kërkesat procedurale të palëve në proces dhe njoftimi me shpallje i palëve të paditura”.*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10²⁸ çështjeve të përzgjedhura me short, 2²⁹ vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari, si dhe vendimeve të administruara për shkak të ankesave.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se në çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur brenda standardeve minimale kohore, ku referuar Vendimit nr.261/2 të KLD, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezulton:

Çështje penale të kategorisë krime:

- Dosja 1 - (është caktuar me short në datën 19.12.2013 dhe ka përfunduar në datën 27.01.2014) Gjykimi ka zgjatur 39 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 2 - (është caktuar me short në datën 07.12.2015 dhe ka përfunduar në datën 02.02.2016) Gjykimi ka zgjatur 52 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);

²⁸ Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim, konkretisht vendimi nr.4, datë 27.01.2015.

²⁹ Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim, konkretisht vendimi nr.476, datë 22.12.2016.

- Dosja 7 - (është caktuar me short në datën 07.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 18.09.2014) Gjykimi ka zgjatur 73 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 11 - (është caktuar me short në datën 08.06.2016 dhe ka përfunduar në datën 12.07.2016) Gjykimi ka zgjatur 34 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Vendimi 1 - (është regjistruar në datën 25.04.2014 dhe ka përfunduar në datën 30.09.2014) Gjykimi ka zgjatur 158 ditë, brenda afatit 12 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime-në minimum jo më pak se 10 vjet burgim);
- Vendimi 2 - (është regjistruar në datën 03.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 07.01.2015) Gjykimi ka zgjatur 338 ditë, brenda afatit 12 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime-në minimum jo më pak se 10 vjet burgim);
- Çështja penale me nr. 131/363 (01557) regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Skënder Seferi, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i K.Penal, referuar relacionit të datës 08.02.2017, të Inspektoratit të KLD ku është trajtuar ankesa e paraqitur nga shtetasit F.S. dhe T.S., për zvarritje të gjyqimit, i është caktuar me short gjyqtarit {...} në datën 12.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 11.12.2015. Gjykimi ka zgjatur 1 vit e 10 muaj e 2 ditë, tej afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

Çështje penale të kategorisë kundërvajtje:

- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 06.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 25.11.2015) Gjykimi ka zgjatur 172 ditë, por në kohëzgjatjen e gjyqimit është përfshirë muaji gusht, në të cilin gjyqtarët marrin lejen vjetore. Nëse do të zbritet periudha e muajit gusht, rezulton se gjykimi ka përfunduar për 141 ditë, tej afatit 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë kundërvajtje);

Çështje civile:

- Dosja 3 - (është caktuar me short në datën 26.03.2015 dhe ka përfunduar në datën 15.07.2015) Gjykimi ka zgjatur 111 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 4 - (është caktuar me short në datën 09.04.2015 dhe ka përfunduar në datën 15.02.2016) Gjykimi ka zgjatur 312 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 8 - (është caktuar me short në datën 03.11.2014 dhe ka përfunduar në datën 05.01.2015) Gjykimi ka zgjatur 63 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 10 - (është caktuar me short në datën 08.10.2015 dhe ka përfunduar në datën 16.01.2016) Gjykimi ka zgjatur 100 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Në çështjen civile nr.238/959 regjistri, të administruar për shkak të ankesave, sipas të dhënave në vendim nr. 255, rezulton se data e regjistrimit është 12.10.2015 dhe data e

përfundimit të çështjes 21.04.2016. Çështja ka përfunduar për 191 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;

- Në çështjen civile nr.418 regjistri, të administruar për shkak të ankesave, sipas të dhënave në vendim nr. 406, rezulton se data e regjistrimit është 10.03.2015 dhe data e përfundimit të çështjes 24.06.2015. Çështja ka përfunduar për 106 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Në çështjen civile nr.849 regjistri, të administruar për shkak të ankesave, sipas të dhënave në vendim nr. 669, rezulton se data e regjistrimit është 08.07.2013 dhe data e përfundimit të çështjes 04.10.2013. Çështja ka përfunduar për 88 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;

Çështje familjare:

- Dosja 6 - (është caktuar me short në datën 23.12.2013 dhe ka përfunduar në datën 10.04.2014) Gjykimi ka zgatur 108 ditë, brenda afatit 4 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet familjare;

Kërkesa civile:

- Në kërkesën civile nr.487 regjistri, të administruar për shkak të ankesave, me objekt "Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të vendimit civil",³⁰ sipas të dhënave në vendimin nr. 487, rezulton se data e regjistrimit është 12.10.2016 dhe data e përfundimit të çështjes është 20.10.2016. Çështja ka përfunduar për 8 ditë, brenda afatit 2 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile pa palë kundërshtare;

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në 17 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër referohet më sipër, 4 prej tyre kanë përfunduar tej standardit minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD. Pra, në total, 23.52% e çështjeve janë gjykuar jashtë afatit standard minimal kohor.

Përqindja matematikore prej 23.52% përkon me nivelin e vlerësimit 3 (tre) pikë, por vlerësuesi, veç analizës matematikore, duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Pavarësisht se 23.52% e çështjeve janë shqyrtuar në tejkallim të standardit minimal kohor të vendosur, rezulton se kjo përgjithësisht nuk është pasojë e mosmenaxhimit efektiv të procesit, por pasojë e ecures procedurale të çështjes. Thuhet "përgjithësisht" pasi evidentohet se vonesa në shqyrtimin e çështjeve penale ka ardhur edhe si pasojë e planifikimit të seancave gjyqësore tej afatit maksimal prej 15 ditë, të parashikuar në nenin 324 të K.Pr.Penale.³¹

³⁰ Çështja konsiderohet se nuk ka afat ligjor shqyrtimi, pasi në nenin 511/a të K.Pr.Civile, pas ndryshimeve me ligjin 122/2013, në fuqi në kohën e dhënies së vendimit, nuk parashikohen afat ligjore brenda të cilës gjykata duhet të shqyrtojë kërkesën, sikurse parashikohet në paragrafin b), c) apo ç) po të këtij neni. Konkretisht në nenin 511/a të K.Pr.Civile parashikohet "Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, i cili: a) për rastet e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b" të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit, brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor;..."

³¹ Konkretisht, në çështjet objekt verifikimi në relacionin e datës 08.02.2017 është evidentuar se në 45 seanca gjyqësore të zhvilluara, 13 prej tyre janë planifikuar tej afati maksimal prej 15 ditë të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.Penale, duke mos i prezantuar asnjë rast mbi shkaqet e këtij planifikimi tej afatit.

Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtari ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2259 çështje, nga të cilat 1008 çështje³² kanë qenë çështje me palë kundërshtare, mesatarisht 336 çështje themeli në vit,³³ dukshëm më i lartë se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD, për gjyqtarin e gjykatës së shkallës së parë, gjykatë që nuk është e organizuar në seksione.

KONKLUSIONE

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuara, që rezultojnë në masën 23.52%; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, të cilat, nga dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) standardi sasior i punës i cili është dukshëm më i lartë se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD (*68 % më shumë se standardi sasior i punës*), gjyqtari për këtë tregues vlerësohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” aftësia e gjyqtarit vlerësohet “10-20 %”, duke e pikëzuar me 4 pikë.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruara për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

³² 365 civile me palë kundërshtare, 268 familjare, 5 çështje tregtare, 370 çështje penale.

³³ Gjyqtari i shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundravajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5) deri në 10 muaj e 6 ditë (shih dosjen 4). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 10 muaj e 6 ditë ka qenë çështje civile themeli, në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim themeli pranimit i padisë dhe vendimi ka marrë formë të prerë në 04.05.2016 pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse (shih dosjen 4). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 2 ditë (shih dosjen 1), 1 muaj e 25 ditë (shih dosjen 2) dhe 3 muaj e 19 ditë (shih dosjen 3). Ndër këto 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste është respektuar afati standard e ai ligjor i gjykimit (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 5). Ndërsa në 1 rast afati standard i gjykimit prej 6 muajsh për çështjen civile është tejkaluar (shih dosjen 4). Shkak për tejkalimin e afatit standard kanë qenë kërkesat procedurale të palëve në proces dhe njoftimi me shpallje i palëve të paditura. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore, të cilat janë 2 vendime penale dhe një masë sigurimi, të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit konstatohet se ato kanë zgjatur 5 muaj e 12 ditë (shih dokumentin 1), 11 muaj e 4 ditë (shih dokumentin 2) dhe 2 ditë (shih dokumentin 3). Në të treja këto raste, gjykimi ka përfunduar brenda afatit standard të Sistemit të Vlerësimit pika 5 gërma "a", i cili është 12 muaj dhe brenda afatit ligjor (48 orë) të parashikuar në K.Pr.Penale”.*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, 2 (dy) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari, si dhe 4 (katër) vendimeve të administruara për shkak të ankesave, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.³⁴

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (nga 17 çështjet e marra në analizë, nga të cilat 1 çështje familjare, 8 çështje penale themeli, 7 çështje civile themeli dhe 1 çështje civile pa palë kundërshtare), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Familjare”, rezulton të jetë 108 ditë, rreth 3 muaj e 18 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e mosmarrëveshjeve familjare.³⁵
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 6 (gjashtë) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë 194 ditë ose 6 muaj e 14 ditë, pra më

³⁴ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” *Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.*

³⁵ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “*d. Gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj”.*

e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale “krime” në Gjykatën e Shkallës së Parë.³⁶

- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale kundërvajtje”, rezulton të jetë 141 ditë ose 4 muaj e 21 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale “kundërvajtje” në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 7 (shtatë) çështje në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë 139 ditë, rreth 4 muaj e 19 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.³⁷
- (v) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Kërkesa civile pa palë kundërshtare”, rezulton të jetë 8 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare në Gjykatën e Shkallës së Parë.³⁸

KONKLUSIONE

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon më një pikëzim prej 4 pikësh. Mbështetur në të njëjtin analizë si ajo e treguesit të mësipërm (*treguesi 2.A.b “Plotësimi i standardeve minimale kohore”*), gjyqtari për këtë tregues pikëzohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, pasi gjyqtari ka përballuar një numër shumë të lartë çështjesh, duke tejkaluar standardin minimal kohor në masën 68%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;

³⁶ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

³⁷ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshme, jo më tej se 6 muaj”.

³⁸ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “j. Gjykimet e çështjeve të karakterit administrativo-penal dhe i çështjeve civile pa palë kundërshtare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 2 muaj”.

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “*Subjekti rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ai ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim për vitet 2014-2016 gjithsej 2713 çështje dhe ka përfunduar si kryesues (relator) 2569 çështje, duke mbartur vitin e fundit 144 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 94.6 %*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave të pasqyruar në Formularin e vetëvlerësimit profesional,³⁹ gjyqtari ka deklaruar se në të gjithë periudhën e vlerësimit i janë caktuar 2713 çështje dhe ka përfunduar gjykimin për 2569 çështje. Ndërkohë, referuar të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë konstatohet se në periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjyqtari {...} ka përfunduar 2259 çështje, nga të cilat 370 çështje penale, 365 çështje civile, 268 çështje familjare, 5 çështje tregtare, 445 kërkesa në fazën e hetimit paraprak, 300 kërkesa civile dhe 506 kërkesa penale.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 94.6 % i përcaktuar ne faqen 32 të Raportit, faqe 862 e dosjes së rivlerësimit

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 94.6%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “Mbi 93-99%”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

³⁹ Në faqen 3 të tij

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, u bazuam në shkresën 441/1 prot datë 03.07.2020 të kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për dorëzimin e arsyetuar të dosjes gjyqësore në sekretarinë gjyqësore. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...} i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet ligjore, me përjashtim të vendimit të dosjes 4 çështje civile, e cila është dorëzuar 1 muaj e 2 ditë nga shpallja. Kjo vonesë nuk ka sjellë pasojë për palët në proces, pasi prej tyre nuk është paraqitur ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer ditën e shpalljes (shih dosjen 1, 2 e 3), ndërsa për dosjen 5 e dhëna është sjellë lidhur me vendimin për vërtetimin e urdhrin të mbrojtjes, i cili është kryer ditën e shpalljes dhe jo vendimin për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, pasi gjykimi i çështjes përfundon me shpalljen e vendimit përfundimtar nr. 4 datë 27.01.2015. Aftësia e tij për gjykimin e shpejtë të çështjeve dhe mosdorëzim në afat të vendimeve gjyqësore është bërë edhe objekt ankesash. Konkretisht, Inspektorati ka verifikuar 7 ankesa dhe rezultatet janë si më poshtë: 2 ankesa të vitit 2014 verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit ndër të cilat për 1 është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional, ndërsa për tjetër nuk kanë rezultuar shkelje nga gjyqtari. 1 ankesë e vitit 2014 e cila është informacion periodik nga kryetari i gjykatës është verifikuar për mosdorëzim në afat të vendimeve gjyqësore dhe nuk kanë rezultuar shkelje nga gjyqtari. 2 ankesa të vitit 2015 ndër të cilat 1 verifikuar për zvarritje gjykimi nuk ka rezultuar shkelje nga gjyqtari, ndërsa 1 për mosrespektim formal të ligjit, cenim i vendimit gjyqësor, zvarritje gjykimi është vendosur arkivim i*

pretendimeve për zvarritje gjykimimi dhe mosrespektim formal të ligjit dhe evidentimi për efekt vlerësimi vetëm për cenimin e vendimit. 2 ankesa të vitit 2016 të cilat janë informacion periodik nga kryetari i gjykatës janë verifikuar për mosdorëzim në afat të vendimeve gjyqësore dhe shkeljet janë regjistruar për efekt vlerësimi etik e profesional (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së). Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...}, ndonëse ka patur ngarkesë mjaft të lartë sasiore, e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, si dhe i kushton rëndësi kohës së arsytimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor”.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsytuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsytuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (*neni 308 paragrafi 2*), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsytuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsytuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja 1, që i përket vendimit penal me nr. 22, datë 27.01.2014, është dorëzuar në datën 27.01.2014 - (ditën e shpalljes së vendimit), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 2, që i përket vendimit penal me nr.37, datë 02.02.2016, është dorëzuar në datën 02.02.2016 - (ditën e shpalljes së vendimit), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 3, që i përket vendimit civil me nr. 449, datë 15.07.2015, është dorëzuar në datën 15.07.2016 - (ditën e shpalljes së vendimit), brenda afatit 5 ditor, të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile (*shtyrë për shpallje të arsytuar*);
- Dosja 4, që i përket vendimit civil me nr. 83, datë 15.02.2016, është dorëzuar në datën 17.03.2016 - (31 ditë), **jashtë afatit** 5 ditor, të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile (*shtyrë për shpallje të arsytuar*);
- Dosja 5, që i përket vendimit civil me nr.04, datë 27.01.2015 është dorëzuar në datën 27.01.2015 - (ditën e shpalljes së vendimit), brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 17 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë,⁴⁰ lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 21.09.2021, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit civil me nr. 190, datë 10.04.2014 është dorëzuar në datën 10.04.2014 - (ditën e shpalljes së vendimit), brenda afatit 10 ditor, të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- Dosja 7, që i përket vendimit penal me nr.383, datë 18.09.2014 është dorëzuar në datën 26.09.2014 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 8, që i përket vendimit civil me nr.2, datë 05.01.2015 është dorëzuar në datën 05.01.2015 - (ditën e shpalljes së vendimit), brenda afatit 5 ditor, të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile (*shtyrë për shpallje të arsyetuar*);
- Dosja 9, që i përket vendimit penal me nr. 510, datë 25.11.2014 është dorëzuar në datën 01.12.2015 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 10, që i përket vendimit civil me nr. 23, datë 19.01.2016 është dorëzuar në datën 23.01.2016 - (4 ditë), brenda afatit 5 ditor, të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile (*shtyrë për shpallje të arsyetuar*);
- Dosja 11, që i përket vendimit penal me nr.220, datë 12.07.2016 është dorëzuar në datën 28.07.2016 - (16 ditë), **jashtë afatit** 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Në relacionin e datës 28.09.2016, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimit nr. 150, datë 15.03.2016 nga gjyqtari {...}, ku ka rezultuar se dosja që i përket vendimit civil nr. 150, datë 15.03.2016, është dorëzuar në sekretarinë e asaj gjykate në datën 15.04.2014, pra pas 31 ditësh nga shpallja, **jashtë afatit** 10 ditor, të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

Po kështu, në relacionin e datës 22.12.2016, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimit penal me nr. 27, datë 20.01.2016, dorëzimin e vendimit civil nr. 27, datë 20.01.2016 dhe dorëzimin e vendimit civil nr. 29, datë 21.01.2016, nga gjyqtari {...}, ku ka rezultuar se:

- dosja që i përket vendimit penal nr.27, datë 20.01.2016, është dorëzuar nga gjyqtari në datën 22.02.2016, pra pas 33 ditësh nga shpallja, **jashtë afatit** 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- dosja që i përket vendimit civil nr.27, datë 20.01.2016, është dorëzuar nga gjyqtari në datën 22.02.2016, pra pas 33 ditësh nga shpallja, **jashtë afatit** 10 ditor, të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;

⁴⁰ Shkresa nr. 655/1 Prot., datë 27.09.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4187/1 Prot., datë 29.09.2021, si dhe shkresa nr. 657/2 Prot., datë 01.10.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4187/2, datë 05.10.2021.

- dosja që i përket vendimit penal nr.29, datë 21.01.2016, është dorëzuar nga gjyqtari në datën 22.02.2016, pra pas 32 ditësh nga shpallja, jashtë afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Referuar të dhënave si më sipër, për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 4 vendimeve objekt verifikimi në relacionet e Inspektoratit të KLD, koha mesatare e arsyetimit të vendimit për çdo kategori të çështjeve, rezulton: për kategorinë penale krime, për 5 dosje është 4.8 ditë; për kategorinë penale kundërvajtje, për 1 dosje është 6 ditë; për kategorinë civile me palë kundërshtare, për 5 dosje është 19.6 ditë; për kategorinë familjare me palë kundërshtare, për 2 dosje është 0 ditë dhe për kategorinë kërkesa në fazën e hetimit paraprake, për 2 dosje është 32.5 ditë. Pra, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, rezulton “Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”, që sipas metodologjisë përkon më një pikëzim prej 9 pikësh.

Lidhur me shkaqet e dorëzimit me vonesë të vendimeve të arsyetuara në relacionin e datës 22.12.2016, analizohet se “...Shkaku kryesor në dorëzimin me vonesë të 3 vendimeve nga gjyqtari {...} mbetet ngarkesa tejet e lartë në punë, ngarkesë kjo mbi normalen dhe e papërbalueshme nga gjyqtari. Kjo ngarkesë lidhet me numrin e ulët në organikën e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, vetëm 5 gjyqtare.... Sipas statistikës që na u vu në dispozicion nga Kancelarja e Gjykatës Lezhë, rezultoi se gjyqtari {...} në periudhën tre mujore janar-mars 2016 ka dhënë gjithsej 266 vendime penale dhe civile, ka ngarkesën më të lartë se të gjithë gjyqtarët e asaj gjykate, ku mesatarisht ka dhënë 88 vendime përfundimtare çdo muaj, ose katër vendimeve në çdo ditë pune. Më këtë ngarkesë, pa llogaritur numrin e lartë të seancave të zhvilluara, çdo ditë (gjyqtari ka mbi 200 dosje në gjykim në dorë), është objektivisht e pamundur për gjyqtarin {...} që të arsyetojë brenda afatit ligjor vendimet e dhëna prej tij”.

Shkaqet e dorëzimit me vonesë të vendimeve të arsyetuara janë shqyrtuar edhe gjatë procedurës së rivlerësimit kalimtar, ku, sipas vendimit nr.373, datë 23.04.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari ka dhënë shpjegime duke pretenduar se sipas raportit të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, gjatë vitit 2016 ai ka zhvilluar në total 2843 seanca, mesatarisht 11 seanca në ditë, fakt që provon për një ngarkesë dukshëm më të lartë se ajo normale, e cila është reflektuar në mosarsyetimin dhe dorëzimin në kohë të vendimeve gjyqësore. Pas administrimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga gjyqtari, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vlerësuar se referuar raportit vjetor për seancat e zhvilluara me audio të datës 13.4.2021, subjekti i rivlerësimit ka pasur një ngarkesë shumë të lartë të çështjeve për shqyrtim për vitin 2016, duke e tejkalluar standardin sasior të kërkuar në germën “g” të pikës 3, të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve dhe se kjo ngarkesë duket të jetë bërë shkak për vonesën në arsyetimin e vendimeve nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni arrin në këtë konkluzion, nisur edhe nga fakti që nuk pasur një dispozitë konkrete imperative në drejtim të normimit të afatit për arsyetimin e vendimeve, afat i cili u përfshi në legjislacionin procedural me ndryshimet e vitit 2017.

KONKLUZIONE

Referuar metodologjisë, vlerësuesi vlerëson rezultatet e analizës matematikore të të dhënave statistikore sipas një analize logjike të tyre, duke evituar shkaqet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Gjithsesi ato nuk mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se rritja me një shkallë, që i përgjigjet koeficientit 20%. Evidentohet se 3 (tre) vendimet e analizuara më sipër janë dorëzuar me vonesë dhe koha e kësaj vonese (33 dhe 32 ditë) ndikon në mesataren e kohës së arsyetimit për 2 (dy) nga 5 (pesë) kategoritë e çështjeve. Sikurse analizohet më sipër, shkak për arsyetimin me vonesë të këtyre vendimeve është bërë ngarkesa e punës e përballuar nga gjyqtari, e cila është dukshëm më e lartë se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD, për gjyqtarin e gjykatës së shkallës, së parë, gjykatë që nuk është e organizuar në seksione. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar konsiderohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 2 seanca (shih dosjen 1), me 3 seanca (shih dosjen 2), me 8 seanca (shih dosjen 3), me 17 seanca (shih dosjen 4) dhe me 1 seancë (shih dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 31 seanca gjyqësore, nga të cilat 21 seanca kanë qenë

produktive. Pengesë në 10 seanca gjyqësore ka qenë kërkesa e palës së paditur për shtyrje, për thirrjen e dëshmitarit dhe identifikimin e emrit të ekspertit, si dhe shtyrja për kërkimin i të dhënave për identitetin e adresën e të paditurës pasi rezultoi me banim në Tiranë (3 seanca), kërkesa për shtyrje e palës paditëse për shkak të ligjshëm (1 seancë), kërkesat e palës paditëse për shtyrje të seancave për njoftim me shpallje të personit të tretë dhe për shkak se nuk vërtetohet marrja e palëve të paditura (5 seanca)”.

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, të gjitha vlerësohen si çështje me palë kundërshtare, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, të administruara në dosjen e rivlerësimit konstatohet:

➤ Dosja 1 – që i përket çështjes penale me nr. 68/313 regjistri, datë regjistrimi 19.12.2013, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe “Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga nenet 291 dhe 242 të K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr. 22, datë 27.01.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka patur seanca joproduktive.

➤ Dosja 2 – që i përket çështjes penale me nr.132/613 regjistri, datë regjistrimi 04.11.2015, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Falsifikim i letërnjoftimeve, i pasaportave dhe i vizave”, i parashikuar nga neni 189/1 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr. 37, datë 02.02.2016, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nuk ka patur seanca joproduktive.

➤ Dosja 3 – që i përket çështjes civile me nr.467 regjistri, datë regjistrimi 25.03.2015, me objekt “Detyrim kthim shume dhe dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar si rezultat i vonesës në kthimin e shumës”, ka përfunduar me vendimin nr.449, datë 15.07.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 7 (shtatë) seanca gjyqësore, nuk ka patur seanca joproduktive. Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: paraqitjen e provave të reja në dobi të gjykimit, njoftimin e dëshmitarit apo ekspertit të kërkuar nga pala e paditur, lënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit, lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim, apo për shpalljen e vendimit të arsyetuar.

➤ Dosja 4 – që i përket çështjes civile me nr.217/503 regjistri, datë regjistrimi 08.04.2015, me objekt “Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të prokurës së posaçme”, ka përfunduar me vendimin nr.83, datë 15.02.2016, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 10 (dhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 4 (katër) seanca kanë qenë joproduktive, pasi është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të palës paditëse apo të mos njoftimit të palës së paditur. Të gjitha seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimin e personit të tretë, të kërkuar gjatë gjykimit nga pala paditëse, njoftimin me shpallje të personit të tretë, lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim, apo për shpalljen e vendimit të arsyetuar.

➤ Dosja 5 – që i përket çështjes civile me nr.04 regjistri, datë regjistrimi 07.01.2015, me objekt “Lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”, ka përfunduar me vendimin nr.04, datë 27.01.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka patur seanca joproduktive. Në seancën e parë është marrë në shqyrtim kërkesa për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, ndërsa në seancën e dytë gjyqtari ka shqyrtuar vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet:

➤ Dosja 6 – që i përket çështjes civile me nr.94/1199 regjistri, datë regjistrimi 23.12.2013, me objekt “Ndryshim vendimi”, ka përfunduar me vendimin nr.190, datë 10.04.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) seancë ka qenë joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së ekspertës.

➤ Dosja 7 – që i përket çështjes penale me nr. 486 regjistri, datë regjistrimi 07.07.2014, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.383, datë 18.09.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) seancë ka rezultuar joproduktive, për shkak të mungesës së njoftimit të të pandehurit.

➤ Dosja 8 – që i përket çështjes civile me nr.146/845 regjistri, datë regjistrimi 31.10.2014, me objekt “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”, ka përfunduar me vendimin nr.2, datë 05.01.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproduktive.

➤ Dosja 9 – që i përket çështjes penale me nr.4341 regjistri, datë regjistrimi 05.06.2014, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.510, datë 25.11.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 9 (nëntë) seanca gjyqësore, nga të cilat 7 (shtatë) seanca kanë rezultuar joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së prokurorit apo të të pandehurit. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimin e avokatit të caktuar kryesisht, apo për t’u lënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimeve përfundimtare me shkrim.

➤ Dosja 10 – që i përket çështjes civile me nr.235/931 regjistri, datë regjistrimi 05.10.2015, me objekt “Pavërtetësi e pjesshme e shënimeve të fletës së regjistrin themeltar”, ka përfunduar me vendimin nr.23, datë 16.01.2016, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproduktive.

➤ Dosja 11 – që i përket çështjes penale, me nr.299 regjistri, datë regjistrimi 23.05.2016, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.220, datë 12.07.2016, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nuk ka patur seanca joproduktive. Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe

procedurale, të tilla si: lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim, apo për shpalljen e vendimit të arsyetuar.

Nga tërësia e të dhënave që parashtrohen më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 11 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli dhe civile themeli) varion nga 2, deri në 10 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 4.2 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (*çështje civile themeli dhe penale themeli*) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile, nenin 333 e vijues dhe 342 të K.Pr.Penale, nenin 132 të Kodit të Familjes dhe parashikimet e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*). Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimin e palëve, dhënien kohë palëve për të paraqitur prova, për t’i dhënë kohë mbrojtësve për t’u njohur me aktet, për përgatitjen e aktin të ekspertimit, për të përgatitur prapësimet, për të përgatitur diskutimin përfundimtar me shkrim, etj. Në përgjithësi, në rastet e shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, ndërsa në çështjet civile, pavarësisht se nuk rezulton të jetë parashikuar në ligjin procedural të kohës një afat për shtyrjen e seancave gjyqësore, ato në çdo rast janë planifikuar brenda afateve të arsyeshme.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 11 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.2, por, rezulton gjithashtu se gjyqtari ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me këtë tregues, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje shpejt nga 1 - 8 ditë nga marrjen e akteve të çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në 2 çështjet civile të vëzhguara, ai ka kryer veprimet përgatitore, të cilat janë dokumentuar rregullisht me procesverbal (shih dosjet 3 dhe 4). Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 2 seanca (shih dosjen 1), me 3 seanca (shih dosjen 2), me 8 seanca (shih dosjen 3), me 17 seanca (shih dosjen 4) dhe me 1 seancë (shih dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 31 seanca gjyqësore, nga të cilat 21 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 10 seanca gjyqësore ka qenë kërkesa e palës së paditur për shtyrje, për thirrjen e dëshmitarit dhe identifikimin e emrit të ekspertit, si dhe shtyrja për kërkimin i të dhënave për identitetin e adresën e të paditurës pasi rezulton me banim në Tiranë (3 seanca), kërkesa për shtyrje e palës paditëse për shkak të ligjshëm (1 seancë), kërkesat e palës paditëse për shtyrje të seancave për njoftim me shpallje të personit të tretë dhe për shkak se nuk vërtetohet marrja dijeni e palëve të paditura (5 seanca). Orari i fillimit dhe i mbarimit të seancës gjyqësore është dokumentuar saktësisht në procesverbal. Nga vëzhgimi i tyre ka rezultuar se ka patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore nga orari i planifikuar. Këto vonesa kanë qenë nga 17-55 minuta dhe nga gjyqtari nuk është relatuar dhe dokumentuar në procesverbal shkak i vonesës (shih dosjet 1 - 4). Gjyqtari {...} e ka respektuar solemnitetin, duke zhvilluar gjykimin gjithmonë në sallë dhe duke i regjistruar audio seancat gjyqësore (shih dosjet 2-5). Këtu bën përjashtim një çështje penale, ku 2 seancat gjyqësore nuk evidentohet nëse janë zhvilluar në sallë apo zyrë dhe nuk janë dokumentuar me regjistrim audio (shih dosjen 1). Gjatë gjykimit, gjyqtari {...}{...}

identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara për realizimin e tyre dhe përgjithësisht me bazë ligjore. Distanca kohore midis seancave në çështjet civile, janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë duke filluar nga 3-27. Është konstatuar vetëm 1 seancë gjyqësore e planifikuar në kohë të tejzgjatur 1 muaj e 9 ditë, e cila përkon me lejen vjetore të muajit gusht (shih dosjen 4). Distanca kohore në çështjet penale ka qenë brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në K.Pr.Penale. Përgjithësisht, ai ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për të siguruar zhvillimin korrekt të gjykimit, megjithëse janë identifikuar edhe raste kur seanca gjyqësore ka dështuar për shkak të njoftimit (2 seanca). Subjekti i rivlerësimit është kujdesur në të gjitha rastet për të respektuar afatin ligjor 5 ditor, për shpalljen e vendimit të arsyetuar parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile, apo për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, sipas parashikimeve të nenit 302 K.Pr.Civile. Dosja 5 e vëzhguar është dosje civile lëshimi i menjëhershëm i urdhrimit të mbrojtjes është gjykuar me 1 seancë dhe në respektim të afatit të parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në të cilin përcaktohet se: “Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës”. Gjyqtari {...} zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatit dhe hetimit gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural, merr rregullisht mendimin e palëve në gjykim. Ai i kushton rëndësi kërkimeve procedurale të palëve, në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së plotë të palëve në proces dhe të dëgjimit të pretendimeve të tyre, si dhe kujdeset për të realizuar palët të drejtën e mbrojtjes apo përfaqësimit me avokat, si dhe caktimin e ekspertit kur duhen njohuri të posaçme për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Disponon me vendime të ndërmjetme për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit”.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, të gjitha u përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare. Gjyqtari në çdo rast i ka vënë në lëvizje çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile dhe caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, në çdo rast, duke filluar nga 1 (një) ditë, deri në 8 ditë pas caktimit të çështjes me short. Në çështjen penale është respektuar afati procedural 10 ditor, i parashikuar në nenin 333/1 të Kodit të Procedurës Penale. Seancat përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, duke u mbajtur me sistemin e regjistrimit audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në çështjet civile: Përgjithësisht, rezulton që seancat gjyqësore të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, relativitetin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijëni nga palët

që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve (në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla), deklarimin të hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe të provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në çështjen penale: Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal, sipas parashikimeve të neneve 405 e vijues të K.Pr.Penale (është proceduar me gjykim të shkurtuar). Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për të relatuar verifikimin e paraqitjes së palëve e të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 2 deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë, konstatohet një numër i konsiderueshëm seancash të filluara me më shumë se 23 minuta me vonesë, deri në 55 minuta me vonesë nga ora e planifikuar, por në asnjë rast nuk konstatohet që fillimi me vonesë i seancës të jetë bërë shkak për dështimin e seancës gjyqësore.

KONKLUZIONE

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efijencës së treguar nga gjyqtari në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Përgjithësisht, rezulton se shkak për fillimin me vonesë të seancave gjyqësore është bërë mungesa e sallave të lira të gjykimit. Nga ana tjetër, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe të dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil dhe penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi : Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadi apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda të njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjen penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet sipas rendit kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar,

diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

3. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare,

fletëthirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore*), si dhe aktet e paraqitura nga palët (*konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONE

DUKE IU REFERUAR BURIMEVE TË VLERËSIMIT, REZULTON SE GJYQTARI KA SHKALLË AFTËSIE SHUMË TË LARTË NË KËTË TREGUES

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	97

4. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...} (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së). Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt”*.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.6479/4 Prot., datë 20.10.2020 rezulton se 1 (një) ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje të gjyqimit dhe i është evidentuar gjyqtarit për efekt vlerësimi etik dhe profesional, si dhe 2 (dy) ankesa janë verifikuar për mosdorëzimin në afat të vendimeve gjyqësore dhe ankesat i janë regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi etik e profesional.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që të dëshmojnë shfaqje e sjellje që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Nuk konstatohet që në vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.2509/2 Prot., datë 19.01.2022, të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.6479/4 Prot., datë 20.10.2020 rezulton se 1 (një) ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje të gjykimit dhe i është evidentuar gjyqtarit për efekt vlerësimi etik dhe profesional, si dhe 2 (dy) ankesa të vitit 2016 janë verifikuar për mosdorëzim në afat të vendimeve gjyqësore dhe ankesat i janë regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi etik e profesional.

Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”*.⁴¹

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: *“Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”*.⁴²

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë gjyqtarin {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të*

⁴¹ Faqe 17 e vendimit të KPK nr. 373, datë 23.04.2021.

⁴² Faqe 17 e vendimit të KPK nr. 373, datë 23.04.2021.

rivlerësimi. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimi {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimi kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimi (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimi, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari, akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe vendimeve të administruar për shkak të ankesave, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimi nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimi për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Për vetë gjyqtarin {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve”*.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari dhe vendimeve të administruara për shkak të ankesave) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

5. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha é përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me efikën gjyqësore dhe i qartë”.*

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe vendimeve të administruara për shkak të ankesave (*kryesisht procesverbaleve të seancave, regjistrimet e seancave në sistemin audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe vendimeve të administruara për shkak të ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët (ka gjykuar si gjyqtar i vetëm) dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndonëse janë evidentuar raste, që të ketë patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, apo dështim të seancave të planifikuara, këto nuk kanë ardhur për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Nuk ka patur vonesa në arsyetimin e vendimeve, përveç 1 rasti, për të cilin palët nuk kanë patur ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë, që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe të bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 2 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih Trajnimet në 3 Vitet e Fundit). Këto dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 4 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkollës së parë, të paorganizuar në seksione. Subjekti gjithashtu ka deklaruar se ka marrë pjesë edhe në 18 trajnime të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, të cilat i ka shoqëruar me certifikatat përkatëse. Këto trajnime janë jashtë periudhës së rivlerësimit, konkretisht i përkasin periudhës maj 2001-mars 2013 dhe rrjedhimisht, për ato mund të konsultohet lista e inventarit. Nuk dokumentohet që gjyqtari {...} të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale, jashtë Shkollës së Magjistraturës”.*

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr. 688 Prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 2 (dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 4 ditë trajnimi. Gjithashtu, nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë, ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr.8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit

gjqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periodha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.

Aktualisht, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve.⁴³ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale. Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit e miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrjeje.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr. 688 Prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 2 (dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 4 ditë trajnimi.

⁴³ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se : “1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periodha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarit {...} në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë 20 pikë, meqenëse për periudhën 3 vjeçare rezulton pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 4 ditë trajnimi. Kjo, pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrjeje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtarit në aktivitetet trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtari pikëzohet me 20 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të mësipërme të vlerësimit, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit/ekspertit. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e tij në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera. Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo

gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lektor dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore, mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrje në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit, etj.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast të vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të mësipërme të vlerësimit, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën e vlerësimit dhe për rrjedhojë, ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike”, nuk rezulton realizimi i publikimeve nga ana e gjyqtarit, prandaj gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët

Shkëlqyeshëm	91
--------------	----

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	90	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	378	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Mbi mesataren
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Mbi mesataren
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT			
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	11-20 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Mbi 93-99 %
	d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsytuar. 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e 	Shumë e lartë

		<i>përzgjedhura me short).</i>	
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	▪ Dosja e rivlerësimit.	I pa konsiderueshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	Shumë e lartë

		vlerësimi (6 dosjet e përzgjedhura me short).	
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit.	15-120 ditë
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			378
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqy

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR